

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

# TRANSKRIPT

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 18 SHTATOR 2004**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 18 .SEPTEMBRA 2004.GODINE**

---

**SHTATOR – SEPTEMBAR  
2004**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI DITËS**

**Pjesa e parë (solemne)**

Ndarja e dekoratave për personalitetet që kanë kontribuar për çështjen e Kosovës: z. Alojz Mok dhe z. Otto Phon Habsburgh.

**Pjesa e dytë**

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e partive politike;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtaritë kërkimore-shkencore;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për minierat dhe mineralet.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**ДНЕВНИ РЕД**

**Prvi (svečani) deo**

Поделаодликовања личностима које су дали допринос Косовском питању: г. Alojz Mok и г. Otto Phon Habsburgh.

**Drugi deo**

1. Друго разматрање Нацрта закона о финансирању полтичких странака;
2. Друго разматрање Нацрта закона о научно-истраживачко делатношћу;
3. Прво разматрање Нацрта закона о рудницима и рудама.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**AGENDA**

**First (solemn) part**

Solemn decoration of personalities for their contribution on the Kosovo issue: mr. Alojz Mok and mr. Otto Phon Habsburgh.

**Second part**

1. Second reading regarding the financing of the political party draft law;
2. Second reading regarding the scientific reaserch activities draft law;
3. First reading of the Draft – Law on mines and minerals.

# TRANSKRIPT

## NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 SHTATOR 2004

**Seanca plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.**

**Seanca filloi punën në orën 10,00.**

**Seancën e kryesoi akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.**

**Bashkëkryesuese Nafije Gaš, anëtare e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.**

### **KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:**

Mirëmëngjes të gjithëve në sallën e seancave plenare.

Shkëlqesi e Juaj – zoti Hapsburg, i respektuari President Rugova, mysafirë të nderuar, muftiu i Kosovës, përfaqësues të kishës katolike, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ambasador i Republikës së Shqipërisë, kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, deputetë të respektuar.

Janë raste të rralla në histori të parlamenteve, në veçanti i këtij tonit – si Parlament i ri, ndërkombëtarisht i njohur, që sot e kemi në mesin tonë një nga themeluesit e idesë evropiane dhe panevropiane – kryetarin e Parlamentit të Unionit Panevropian, doktorin e shkencave të historisë dhe të politikës, kontribuesin shumë të madh në mbrojtjen e etnive dhe të kulturave të vogla – doktor Hapsburgun.

Më lejoni t’ju them se doktor Oto von Hapsburg është djali më i madh i mbretit të Austro-Hungarisë; dy fëmijët e tij sot japin kontribute shumë të mëdha në Parlamentin Evropian duke kontribuar edhe në hapjen e rrugës së shkatrrimit të komunizmit dhe të krijimit të idesë së njerëzve të lirë në Evropë dhe në botë. Në veçanti, kontributi i doktor Hapsburgut është shumë i madh për Ballkanin dhe Kosovën në një skajshmëri të ndikimit pozitiv të tij dhe përkrahjen që i dhanë Presidentit tonë të respektuar për 15 vjet me radhë.

Prandaj, me kënaqësi të veçantë ia jap foltorën dhe thërras në foltore shkëlqesinë e tij doktor Hapsburg. Shkëlqesi, foltorja është Juaja.

(Duartrokitje)

DR.OTO VON HAPSBURG:

(Transkriptohet i përkthyer nga përkthyesi  
simultan anglisht shqip -

Zoti kryetar i Republikës, zoti kryetar i Kuvendit, zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që si parlamentar i vjetër në mesin tuaj të shpreh kënaqësi të veçantë që jam sot në mesin tuaj. Kam pasur në jetën time më shumë se një herë mundësi të hap parlamente të seancave të para, e të njëjtin rast e kam pasur edhe në Slloveni. Rasti i dytë ka qenë për Parlamentin hungarez. Kam pasur edhe privilegjën të jem aty sepse kam qenë raportues i Parlamentit Evropian dhe dua të them se për mua është privilegjë e veçantë që jam këtu sot me ju, posaçërisht kur prezenton këtu zoti kryetar Rugova, i cili është personalitet i jashtëzakonshëm, aktivitetet e të cilit janë të rëndësishme dhe ato na janë të njohura, e këtë e ka vërtetuar edhe në ditët më të vështira.

Mirëpo, më lejoni që shkurtimisht t'ju them se na vjen keq që kryetari i Fondacionit – ministri i punëve të jashtme – zoti Mok nuk pati mundësi të marrë pjesë këtu për shkaqe shëndetësore dhe vetëm desha t'ju them – të nderuar shokë se zoti Mok ka qenë një ndër njerëzit më të guximshëm dhe një luftëtar më guximtar në luftën për vetëvendosje të të gjithë juve këtu, dhe ju të jeni në mesin e njerëzve të Evropës – si aleancë. Ai gjithnjë ka theksuar se Panevropë është e gjithë Evropa dhe çdonjëri ka të drejtë të bëhet anëtar i Evropës. Shpresoj se ai do ta përcjell nga larg këtë takim tonin, sepse ashtu është dëshira e tij. Po ashtu dua të them se privilegj imja ka qenë të shoh punën e jashtëzakonshme të kryetarit të Republikës së Kosovës dhe ta falënderoj për atë çfarë ka bërë, duke e përkujtuar në Fondacionin e Idesë Evropiane. Idea e tij edhe sot jep rezultate, dhe edhe unë kam qenë njëri ndër përkrahësit e tij që të vazhdojmë rrugë të drejtë, e për këtë kemi patur edhe mundësi. Na kanë thënë se Evropa është krejt në rregull, por në këtë pjesë të kontinentit gjithnjë kemi menduar se Evropa është një dhe një realitet, sepse kur shikojmë në histori atëherë kjo është bazë e drejtë. Se profeti i Evropës Kunof Kalergi ka qenë njeri i cili e ka kuptuar se në çdo aksion të evropianëve dhe ai nuk ka qenë duke luftuar vetëm për vendin e vet, apo për vendet fqinje të shtetit të tij, por ka pasur ndjenjë se ai ka qenë përgjegjës për të gjithë popujt e Evropës, sikur që ne sot jemi. Dhe, me rasti ne nderimit të kryetarit të Republikës tuaj, duhet të theksoj edhe një herë se ai ka qenë në të njëjtën vijë sikur ka qenë Kunof Kalergi dhe

duhet të vazhdoni ta zbatoni këtë rrugë ,sepse kjo është një gjë shumë e rëndësishme.

Zonja dhe zotërinj,

Natyrisht se ju keni probleme të shumta dhe shumë evropianë i kanë kuptuar problemet tuaja dhe këtë e shikojnë në Evropë si problem të njëjtë – problem ekonomik. Por, Evropa është një nga tregjet më të zhvilluara dhe më potenciale në botë dhe ky është fakt të cilin nuk duhet lënë anash. Mirëpo, në anën tjetër, nuk është mirë nëse ne koncentrohemi vetëm në ekonomi, sepse ekonomia është në rregull, por po ashtu ka edhe probleme, sikur që patë thënë një njeri i madh i shekullit të kaluar i Evropës gjeneral De Gol – se ai gjithmonë ka përmendur se çfarë duhet bërë për të ardhmen. Mirëpo, për të ardhmen ekzistojnë disa çështje të cilat duhet të mbijetojnë dhe kjo është ndër gjërat më të rëndësishme, pra aspekti njerëzor i kësaj Evrope e posaçërisht aspekti i të kuptuarit ndërmjet kombeve, sepse ne kemi përjetuar shumë kriza në mijëra vite të zhvillimit. Dhe në shekullin e 19-të, për shembull, ka qenë çështja e nacionaliteteve, që ka qenë mbi të gjitha, nga se unë e kam quajtur këtë si një instrument për t'i hulumtuar vendet. Mirëpo, tash kjo ka dimensione totale të ndryshme. Kemi çështjen e nacionaliteteve dhe të gjuhëve, mirëpo ka efekte të mëdha që kanë ndodhur dhe ndikimi i tij do të shihet në politikë në një kohë të gjatë dhe kjo ka qenë edhe eksplodimi i bombës së parë atomike mbi Hiroshimë. Nuk është vetëm kjo diçka, por desha ta përmend, sepse kam qenë personalisht në Hiroshimë dhe është një vend shumë impresiv dhe për austriakët kjo ka rëndësi të madhe nga se bomba atomike ka rënë mu në një ndërtesë të cilën e kanë ndërtuar austriakët. Mirëpo, kjo tregon se idea e Evropës dhe e Austrisë, sepse Bashkësia Evropiane ka filluar nga Austria dhe në realitet kjo do të qëndrojë për një kohë të gjatë.

Kosova këtu është për ne një rast i rëndësishëm dhe i madh për Bashkësinë e Evropës, ngase një gjë shihet qartë, kemi pasur majën e famshme për ne – Evropën dhe kemi pasur një vit shumë të mirë e ai ka qenë viti në të cilin dhjetë kombe kanë mund t'i bashkohen Bashkësisë Evropiane. Dhe t'ju them diçka juve si parlamentarë dhe le të mbetet kjo mes nesh, se sikur të mos kishte Parlamenti Evropian, lidhur me këtë nuk do të ishim të kënaqshëm, nga se mua më kujtohet shumë mirë se Këshilli që përfaqëson qeveri të ndryshme, të themi kështu në nivel të lartë, ka vendosur në vitin 1994 nga dhjetë kombe që kanë qenë propozuar për anëtarësim – do të pranohen vetëm tri. Dhe lidhur me këtë dihet shumë pak, por Parlamenti këtë doli t'ia kalojë dhe arsyeja për një gjë të tillë është se ne kemi pasur që nga fillimi autoritetin mbi buxhetin.

Miq të dashur, buxheti është instrumenti më i madh dhe ajo që shtyen qeverinë të bëjë diçka – është buxheti. Edhe ky është po i njëjti instrument që duhet të përdoret kohëpaskohe dhe me këtë i jipen të drejtat përfaqësimit parlamentar dhe me Konferencën e Luksemburgut ky buxhet na doli në ndihmë – neve si



Parlament të Evropës dhe t'i shtyjmë anëtarët e Këshillit t'i pranojnë ato tri shtete, nga se për shkaqe teknike aso ose këso do të bëhet më mirë. Një njeri që ka ndihmuar në këtë drejtim ka qenë zoti Mok e që fatkeqësisht nuk është këtu në sallë.

Natyrisht është një gjë që është e rëndësishme për ne, nga se ne duhet qartë të themi se zgjerimi i Bashkësisë Evropiane nuk ka përfunduar dhe se zgjerimi i saj është detyrë e së ardhmes. Panevropa është e tërë Evropa dhe kjo do të thotë që duhet ta njohim edhe slloganin(parullën) e vetëvendosjes së popujve. Në të kaluarën ka pasur argumente dhe ka pasur arsye që të themi se ne nuk duhet lejuar diçka për arsye ekonomike, kjo është e vërtetë. Mirëpo, në fund të Luftës së Parë Botërore, e ashtuquajtura vetëvendosje e shteteve, gjatë atyre viteve asnjë shtet nuk ka qenë e lejuar që vetë të vetëvendosë, mirëpo e gjithë ajo çështje vendosej nga fituesit e Luftës së Parë Botërore. Dhe për shkak të falsifikimit të nocionit të vetëvendosjes ka ndodhur një gjë që e ka shkaktuar krizën që nga atëherë, nga se ne çfarë po shohim sot me sytë tanë është se në fund të luftës së dytë botërore ka patur dy traktate paqësore, njëri ka qenë për Evropën Qendrore – në Sen Zhermen dhe të mos flasim për Versajën, që ka qenë traktati më i madh i paqës, por gjithashtu ka patur edhe traktate në Jesë an Seva, të cilën gjë e kanë bërë për Lindjen e A fërtë dhe sikur ne që bëmë në Evropë edhe sot çfarë shohim, si pasojë e gjithë kësaj ne do të gjejmë se të gjitha gabimet janë të përfundimit të njëjtë. Pra, shihni sot kemi një problem të madh me Irakun. Mirëpo fituesit e Luftës së Parë Botërore për arsye ekonomike kanë themeluar një shtet, në atë kohë ka qenë pjesë e perandorisë turke me tri fusha të ndara dhe këto regjione janë shtyrë që të jetojnë së bashku si një shtet dhe siç mundohen të bëjnë një theks se Shtetet e Bashkuara hynë në Irak dhe njëherë nga figurat kryesore tha se Irakun do ta kthejmë siç ka qenë, kurse unë menjëherë thash se ata e kanë humbur luftën nga se atje situata nuk është që të mund të zgjidhet. Aty duhet rindërtim dhe për disa arsye tjera dhe gjithmonë atje ke politikan, personalisht kam takuar vetëm disa prej, kurse disa prej tyre thojnë ta kthejmë edhe ish Jugosllavinë për shkaqe ekonomike, mirëpo e njëjta gjë do t'i çojë liderët në eksplozim të njëanshëm, prandaj gjithmonë do ta mbaj në mend se vetëvendosja është një gjë e mirë posaçërisht brenda kornizës së Evropës. Katastrofa e vetëvendosjes së falsifikuar në fund të Luftës së Parë pas bashkimit të bazës së Danubit që u thye dhe filloi me krizën ekonomike, dhe ne të gjithë flasim për krizën e bursës së Nju-Jorkut si fillim i krizës. Nuk është e vërtetë. Vërtetë kriza ka filluar, ka qenë arsye e tërë kësaj bankrotimi i bankës në bazën e Danubit dhe për këtë kjo ka ndodhë edhe kjo duhet të përkujtohet në të ardhmen. Sa për fushat tjera, të cilat janë krijuar, si për shembull Jugosllavi, ka qenë e njëjta krizë gjithashtu, që e ka krijuar një problem të pazgjidhur e që sot është një paralele e njëjtë të asaj që po ndodh në Irak nga se ne në Irak kemi pasur këtë ngjarje të kolapsit, të cilin unë pata parashikuar, nga se krijimi i një Iraku të bashkuar është një gjë, sepse krijimi i një Iraku të bashkuar nuk i përgjigjet realitetit në të vërtetë. Dhe nëse



shkojmë te traktatet e Sen Zhermenit, posaçërisht në Austri me krijimin e diktatit, ka patur pasoja serioze të cilat i shohim edhe sot në Irak. Prandaj duhet të angazhohemi lidhur me këtë, dhe këtu është një nga detyrat e rëndësishme, kurse ju miq të dashur këtu në Kosovë keni një vend shumëetnik që në të njëjtën kohë ka një lidhshmëri që e ka një nocion të shtetit dhe nocion të vetëvendosjes finale dhe të jap një shembull se mënyra që impononi zgjidhje të cilat nuk i dëshirojmë ato gjithmonë është mënyrë e gabuar se si bëhen gjërat.

Pra, zonja e zotërinj këtu gjithashtu është çështja e ekonomisë dhe e dini se në të kaluarën ne kemi patur disa probleme ekonomike, sepse të gjitha vendet e vogla që pas pasojave të Luftës së Dytë botërore kanë menduar se izolimi ekonomik është parakusht i zhvillimit të tyre. Në realitet, tash kemi këtë mundësi të jashtëzakonshme në tregun e përbashkët, me euron që të bëjmë vetëvendosjen e mundshme duke u bazuar brenda kufirit të Evropës – nën ombrellën e Evropës dhe gjërat që diku më herët janë kërcnuar tash nuk na kërcnohen nëse ne flasim për vetëvendosjen e popujve. Kjo për evropianët, ngase të gjithë këtu jemi, zonja e zotërinj – të gjithë evropian, që të luftojmë për shtyrjen përpara të kësaj ideje të përgjithshme dhe të themi se duhet të punojmë për krijimin e një Evrope të vërtetë, e posaçërisht që të mos ndalemi në zgjerimin e Bashkësisë Evropiane.

Zonja dhe zotërinj, e di se ka shumë prej nesh që e dimë se për burokratët dhe teknokratët se kjo është e pamundshme dhe se kjo nuk duhet të vazhdohet më tutje. Zonja e zotërinj, e kundërta është e vërtetë. Evropa nuk është vetëm për disa të lumtur, por është për të gjithë evropianët dhe nëse ju e lexoni historinë e Evropës, natyrisht zhvillimi i Evropës ka dalë nga Perëndimi, por gjithashtu ka ardhur edhe nga Lindja, vetëm se nga gjërat e tilla nuk i bisedojmë aq shumë. Kur shkojmë në Austri, nëse shikojmë prej nga erdhi, kah ka ardhur krishterizmi, ai nuk ka ardhur vetëm nga këtu, por ka filluar nga ky territor këtu, nga se si shumë të shenjta, si Sent Severini kjo ka ardhur prej këtu dhe i ka shtyrë këto ide në pjesë tjera të Evropës.

Zonja e zotërinj, këto janë disa mendime të cilat unë këtu dëshirova t'i theksoj para jush, dhe posaçërisht se siç e dini është një krijesë e re dhe është krijuar shteti i jahudive në Izrael. Mirëpo ne do të marrim shembuj nga shteti i Izraelit ,sepse edhe sot e shohim para syve tanë se do të ketë një shtyrje dhe persekutim të madh të evrejve në Rusi kundër oligarkëve dhe kjo më përkujton në fushatën e Stalinit kundër doktorëve. E njëjta gjë është duke ndodhur edhe me Rusinë dhe këtu kemi për ta mbajtur në mend “gjënë” e madhe që iu ka ndihmuar disa njerëzve, është edhe principi se secili jevrej që vjen në Izrael e merr shtetësinë e një Izraeli dhe nuk ekstradohet. Ndoshta duhet bërë një gjë të tillë edhe për juve, nga se do të mbrojmë interesat evropiane dhe qytetarët tanë që të mos i lëmë forcat e ndryshme që t’na përzihen në këtë gjë. Sot problemi është se çka do të bëjmë me këtë Evropë në të cilën dhashtë zoti të hyjnë edhe elementet vendase në të cilën duhet të sjellin impulse të jashtëzakonshme kësaj Evrope. Së pari

është zgjerimi dhe proklamimi, që unë do ta quaj e drejtë për Evropë. Secili popull evropian që dëshiron të jetë anëtar i Bashkësisë Evropiane duhet të ketë të drejtën që posa i ka përmbushur kushtet themelore të shoqërisë së tillë të bëhet anëtare, sepse Evropa nuk është vetëm për ata pak të lumturit që janë aty brenda, por është e drejtë e secilit evropian që të jetë në të dhe kjo e drjetë e përfshin edhe Kosovën.

Në vendin e dytë, gjithashtu duhet menduar për organizimin e brendshëm. Ne kemi argumente se ne kemi pasur aq shumë vështirësi në pranimin e dhjetë popujve të rinj dhe së pari kur kemi të bëjmë me politikë, ju e dini shumë mirë se nëse ekziston një problem para jush dhe e shihni si mund të zgjidhet ju duhet ta zgjidhni menjëherë ngase nuk dihet se a do të vjen rasti i dytë për ta zgjidhur këtë problem. Kjo është një element vendimtar të vendosjes dhe të respektohen edhe të drejtat e minoriteteve, sepse Evropa nuk është diçka që nuk do t'i barazojë të gjithë. Secili prej nesh sjell diçka dhe nga përvoja e punës sime parlamentare dhe qysh se kam hyrë në Parlament me idenë që të punojmë për zgjerimin për të gjithë motrat dhe vëllezërit tanë në Evropë unë kam mësuar se popujt i kanë gjenitë e veta. Për shembull, në Gjermani gjithmonë është thënë se polakët janë në aspektin ekonomik jokompetent dhe kur dikush sheh raportet të cilat janë bërë para hyrjes dhe krijimit të hapave për çështje financiare për hyrje në Bashkimi Evropian rezultatet më të mira i kemi pasur nga polakët. Kjo gjithnjë më ka shtyrë se përvoja në mes Austrisë e Hungarisë, në anën Austriake që ka qenë më pak e centralizuar, popujt kanë zërë vendet në qeveri duke u bazuar prej gjenisë së vet që kanë patur dhe nuk kanë ditur këtë apo kanë patur diçka të shkruar për këtë dhe e kanë kuptuar se në Austri që ka pasur një Ministri të Shëndetësisë, për këtë janë e dhe ukrainianët dhe ata për shembull janë gjenitë për shërbimet shëndetësore e kështu me radhë. Prandaj, duhet ta mbani në mend se Evropa do të ketë një bashkëpunim dhe gjë që do të thotë barazi me të gjithë popujt, por në anën e kundërt do ta mbajnë gjuhën e tyre, aftësitë e tyre e kështu me radhë dhe kjo do të thotë për të gjithë ata ne duhet t'u japim atyre, madje edhe pakicave që ata sjellin vlera të mëdha për ne dhe ne duhet t'i marrim këto vlera dhe falemnderit që i kemi. Falënderojmë zotin që i kemi këto pakica, sepse ata do t'i ndihmojnë shumë zhvillimit. Natyrisht ne duhet gjithashtu të mendojmë për organizimi ne brendshëm të Bashkësisë Evropiane.

T'ju them thjesht, unë jam pak sa i frikësuar rreth zgjerimit të madh të administratës së Bashkësisë Evropiane. Ne nuk duhet lejuar diçka të tillë nga se kemi parlament Evropian i cili ka përtej 700 anëtarëve, kurse Shtetet e Bashkuara që kanë pothuaj popullatë sa kemi ne në Evropë – janë të kënaqur me 360 deputetë. E di që gjatë viteve jam munduar të luftoj për këtë zgjerim dhe për rritjen e numrit të ulseve dhe ka qenë shumë lehtë të marrësh vota në një parlament për zgjerimin e vendeve, nga se të gjithë e kanë parë atë diçka si të sigurt, por të zvogëlosh numrin e ulseve kjo ka qenë shumë vështirë sepse ne

dëshirojmë të krijojmë shumë diçka që është efektive për popullatën tonë dhe sot ne duhet të kalojmë probleme dhe vështirësitë e ndryshme.

Dhe më në fund t'ju them edhe një gjë që për mua është pak a shumë personale dhe ka rëndësi të madhe, e kjo është se Evropa është një shprehje e bindjeve shpirtërore dhe bindjet shpirtërore janë të pandashme dhe është e pandashme me nocionin e zotit. Sot në mëngjes jam zgjuar në ora 5 apo 5 e 30, nuk e kam shikuar aq kohën dhe kam dëgjuar tingullin e kishës dhe zërin e imamit nga xhamia. Kjo më bëri të dij se këtu ka një moral më të lartë, se nuk është një shumicë apo një person që i imponohet të tjerëve dhe ne duhet ta njohim një gjë të tillë dhe ta njohim këtë çështje në Evropë.

Zonja e zotërinj, kjo do të thotë se ju duhet të jeni në Parlamentin e Evropës, dhe ju do të jeni anëtar vendosës të Parlamentit evropian dhe unë dëshiroj vetëm t'ju them se në këtë dhomë ke njerëz prej atyre që do të ulen edhe në Parlamentin Evropian dhe atëherë do të shihni se kjo Evropë do të jetë një sukses i madh, një zhvillim i madh dhe se është i mirë për të gjithë. Ju jeni aty vetëm për të ardhur në Evropë, sepse kjo është e drejtë e juaja, dhe kjo bën të kuptoni se ju keni një detyrë të madhe si kosovar që ta mbani karakterin e kosovarëve në Parlament, sepse keni patur një histori tragjike, sepse kam lexuar diçka nga historia, domethënë keni pasur një histori tragjike qysh para luftës së dytë botërore. Frengët kishin një publikim dhe një diplomat Pire që kishte shkruar një libër të shkëlqyeshëm i cili fatkeqësisht nuk është lexuar, por njerëzit në përgjithësi që e kanë lexuar dhe që erdhën në pozitë ta lexonin atë libër tregonte se kishte pasur përrshkrime të shkatërrimit të popullatës këtu. Ju keni, me fjalë të tjera, detyrë shumë të madhe. Ju mund të jeni shembull i mëtejshëm dhe inspirim për një fuqi, nga se nëse dikush është i vendosur, nëse e bën këtë me miq dhe nëse bashkëpunon me miq, ai gjithashtu mund t'i përmbushë idetë për Parlamentin evropian dhe nëse ka një opozitë të fortë apo një kundërshtar të fortë.

Unë kur e kam filluar punën time në Parlament dhe përfaqësues i Komisionit për Politikën e Jashtme, flas këtu lidhur me Jalltën dhe për një ligj bazë i cili është nxjerrë atëherë dhe ne atëherë kemi patur një shumicë e cila ka dashur njëherë e përgjithmonë që kufiri i Jalltës të jetë kufiri i fundit i Evropës dhe unë atëherë kam qenë ulur bashkë me një grupë njerëzish me të cilët kemi vendosur ta bëjmë ndryshimin, dhe prej katër pjesëmarrësve që i përkitnin katër partive, një ishte nga Britania, tjetri liberal nga Danimarka diplomat i shkëlqyeshëm, pastaj Hakerup dhe një degolist nga Franca dhe përnga nacionaliteti ka qenë jevrej, ne punuam dy vjet që të kishim bërë ato ndryshime të domosdoshme dhe kemi mbivotuar propozimin për themelimin e komisionit për politikën e jashtme. Unë ju lus, kur do të vini në bashkësinë tonë, respektivisht në Bashkësinë Evropiane mos e humbni vullnetin për shkak problemeve në të cilat do të hasni. Problemet

janë gjithnjë të vështirë për t'u zgjidhur, por me dëshirën dhe këmbënguljen ata zgjidhen, kurse ne jemi për atë që Kosova të vendosë vetë për të ardhmen e saj e

unë shpresoj se ju do të jeni në Evropë dhe të gjithë do të kemi një të ardhme më të mirë të përbashkët. Ju falemnderit.

(Duartrokitje frenetike)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë desha në emër të Parlamentit të Kosovës ta falënderoj për një fjalë shumë spiritoze, shumëdomethënëse dhe shumëvendimtare për punën tonë të ardhshme politike, profesionale dhe njerëzore, prandaj shkelqësia juaj edhe një herë: ishte kënaqësi e këtij Parlamenti që t'ju kemi këtu - bashkë me Presidentin Rugova. Ju falemnderit. Zoti ju dhashtë shëndet dhe dëshirojmë të realizohet përcaktimi juaj për vetëpërcaktimin e Kosovës. Ju falemnderit shumë. President, ju falemnderit.

(Ndërprerje – jipet pauzë prej 5 minutash)

(Në ndërkohë kryetari Nexhat Daci shpreh falënderim, duke u përshëndetur me mysafirët pjesëmarrës në seancën plenare - solemne)

(Ndërprerje – sipas inçizimit në CD)

(Pas pauzës...)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E kam në dijeni se Haki Shatri e ka kërkuar fjalën, por përse e ka trusë susten, nuk e di. A është këtu Hakia?

(Ndërprerje)

Unë dua t'ju them se në ora 13 kam diçka tjetër, prandaj po ju lus që të vazhdojmë.

Po habitem, pse kryetari i Komisionit për Tregti dhe Industri, që ka kërkuar aq shumë ta vendosim ligjin në shqyrtim të parë, dhe desha që tash të fillojmë, sepse derisa të vjen koha për të vendosë edhe do të kishim krijuar kuorum.



Pikën e dytë dhe të tretë nuk mund ta filloj ,sepse duhet menjëherë të vendosim dhe për këtë të votojmë, kurse si shihet ende s'kemi kuorum.

(Ndërprerje)

Kërkoj prej jush që t'më ndihmoni: a të presim edhe pak, por duhet ta dijmë se sa duhet të presim?

(Ndërhyerje – pa kyçje të mikrofonit)

Në sa ta vazhdojmë? Mirë. Atëherë, deri në 12,15 po presim për ta krijuar kuorumin, por nëse s'kemi kuorum atëherë nuk vazhdohet puna më tej.

(Jipet pauzë)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mund t'ju informoj se Kryesia e ka vlerësuar drejt rëndësinë e një projektligji shumë të rëndësishëm për procesin e privatizimit, që është në shqyrtim të parë: Projektligjin për minierat dhe mineralet.

Ishte vullnet dhe dëshirë e Kryesisë që ky projektligj sot të kalojë në shqyrtim të parë dhe me 27 kur e kemi seancën tjetër – në shqyrtim të dytë, ashtu që edhe lidhur me atë çështjen që ndërmarrjet në privatizim, si Feronikeli, po edhe tjerat, ta kenë bazën ligjore. Do të thotë, përkundër vullnetit të mirë të Kryesisë, përkundër vullnetit të mirë të një numri të deputetëve që janë 44 – plus tani që erdhën 2 46 dhe meqë çdo pikë e rendit të ditës është e përcaktuar me vendimmarrje, e tani u bënë 50, kurse na nevojiten edhe 11 deputetë...

Prandaj, unë j u falënderoj shumë për këtë pjesëmarrje. Shihemi në se ancën e rregullt të rëdhës që është dhe në emrin tuaj shprehi shqetësim pse po e lëshojmë rastin që një ligj me rëndësi vitale për ekonominë e Kosovës nuk po mund ta kemi në shqyrtim. Ju falemnderit. Mirëupafshim në seancën e rregullt.

Seanca plenare përfundoi punën në orën 12,30.

---

E transkriptoi: RT, Zyra E-04, tel.dir.038-211/860,lok.10-508,rtullari@hotmail.com